

MARRËVESHJE

ndërmjet Qeverisë së Republikës së Austrisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin në Fushat e Kulturës, Arsimit dhe Shkencës

Qeveria e Republikës së Austrisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (të cilat më poshtë do të quhen "Palë kontraktuese"),

- Me qëllim nxitjen dhe zhvillimin sa më të mirë të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në fushat e Kulturës, Arsimit dhe Shkencës,
- me bindjen, se një bashkëpunim i tillë mund të kontribuojë për mirëkuptimin e ndërsjelltë dhe për forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve,
- të vetëdijshëm, që bashkëpunimi i tyre në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të ndikojë pozitivisht mbi bashkëpunimin shumëpalësh në fushën e marrëdhënieve kulturore, veçanërisht në Organizatën për Modalitetet e Edukimit, Shkencës dhe Kulturës së Kombeve të Bashkuara, në Programet e Bashkimit Evropian, dhe në Organizatën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

- (1) Palët kontraktuese mbështesin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të institucioneve në Sistemin Arsimor, në zhvillimin e arteve si dhe në Kulturë, në kuadrin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe përshëndesin e mbështesin gjithashtu bashkëpunimin në fushat e përmendura në rrafshin rajonal e atë lokal.
- (2) Palët kontraktuese përshëndesin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve të tyre në fushën e kërkimit shkencor.

Neni 2

- (1) Palët kontraktuese mbështesin bashkëpunimin ndërmjet Shkollave të Larta, Bibliotekave Shkencore si dhe Institucioneve të tjera shkencore në të dy shtetet.
- (2) Palët kontraktuese përshëndesin ftesa të drejtpërdrejta të të gjitha llojeve për pedagogët/pedagoget e shkollave të larta dhe për studiues/e, për ushtrimin e një veprimtarie mësimdhënëse, për kryerjen e kërkimit shkencor dhe për zhvillimin e mëtejshëm të arteve, si dhe duke patur parasysh Nenin 10, në kuadër të dispozitave të çdo vendi dhe mundësive financiare, do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar, në planin juridik dhe realisht, qëndrimin e të ftuarve.
- (3) Për nxitjen e mësimit të Gjuhës, Letërsisë, Historisë dhe Qytetërimit të vendit tjetër, Palët kontraktuese dërgojnë lektorë/lektore për të ushtruar veprimtari në shkollat e larta. Palët kontraktuese, duke marrë parasysh Nenin 10, në kuadrin e dispozitave të tyre të brendshme dhe mundësive financiare, do të ndërmmarrin gjithçka për të lehtësuar këtë shkëmbim si në planin ligjor ashtu dhe në atë material.

(4) Palët kontraktuese mbështesin studimet në territorin e Palës tjetër kontraktuese. Lidhur me taksat e studimeve, vlejné dispozitat e brendshme të secilës prej Palëve kontraktuese.

(5) Palët kontraktuese ftojnë studentë, të diplomuar, pedagogë/pedagoge të shkollave të larta, punonjës/punonjëse shkencore përkatësisht të palës tjetër kontraktuese, për të konkurruar në programet e bursave të palës tjetër kontraktuese.

(6) Palët kontraktuese përshëndesin pjesëmarrjen e studentëve dhe të të diplomuarve përkatësisht të palës tjetër kontraktuese, si p.sh. në kurse, kolegje verore dhe në aktivitete mësimore plotësuese, ndër të tjera, për përmirësimin e njohurive gjuhësore dhe për kualifikimin e mëtejshëm në fusha me karakter special.

(7) Palët kontraktuese mbështesin bashkëpunimin e mëtejshëm midis institucioneve të shkollave të larta në Shqipëri dhe Austri, veçanërisht në lidhje me krijimin e një Hapësire Evropiane të Arsimit të Lartë, në kontekstin e Procesit të Bolonjës. Në këtë kuadër, të dyja Palët kontraktuese përshëndesin një bashkëpunim më të fuqishëm në kuadrin e Programeve të Bashkimit Evropian në të cilët marr pjesë Shqipëria.

Neni 3

(1) Palët kontraktuese, duke patur parasysh mundësitë financiare, mbështesin bashkëpunimin në fushën e Arsimit të Përgjithshëm dhe veçanërisht në atë profesional, ndër të tjera, nëpërmjet masave të mëposhtme:

- a) shkëmbimit të ekspertëve/eksperteve, si dhe të materialeve të informacionit dhe të dokumentacionit;
- b) dërgimit të një të ngarkuari/e të Shërbimit Publik të vendit dërgues për bashkëpunimin arsimor në Institucionet e Kualifikimit të mësuesve/mësueseve të shtetit pritës, i cili do të financohet plotësisht ose në pjesën më të madhe nga fondet publike;
- c) dërgimit të mësuesve/mësueseve austriake në shkollat shqiptare;
- d) aktiviteteve në fushën e kualifikimit të mëtejshëm të mësuesve/mësueseve për nxitjen e përhapjes së gjuhës së tij në territorin e palës tjetër kontraktuese, si dhe për mbështetjen e masave të marra në kuadrin e zhvillimit të mëtejshëm të shkollës dhe mësimdhënies.

(2) Zbatimi i këtyre masave bëhet me mirëkuptimin e të dyja palëve kontraktuese. Për këtë, hollësitë përcaktohen në programet e Komisionit të përbashkët.

Neni 4

Palët kontraktuese shqyrtojnë kushtet, nën të cilat do të kryehet njohja reciproke e dëftësave të pjekurisë, e rezultateve gjatë studimeve dhe e provimeve, si dhe njohja e titujve shkencore. Për këtë qëllim, ato do shkëmbejnë dispozitat përkatëse dhe do të krijojnë një komisioni ekspertësh, i cili do të rekomandojë njohje të tilla.

Neni 5

Palët kontraktuese mbështesin bashkëpunimin në fushën e arsimit për të rritur, veçanërisht nëpërmjet shkëmbimit të ekspertëve, si dhe nëpërmjet shkëmbimit të materialeve të dokumentacionit dhe informacionit.

Neni 6

(1) Palët kontraktuese, në kuadrin e legjislacioneve të tyre në fuqi, do të lehtësojnë krijimin dhe veprimtarinë e institucioneve ekzistuese kulturore jashtë përfaqësive të tyre diplomatike të Palës kontraktuese të vendit tjetër .

(2) Institucionet Kulturore, në kontekstin e paragrafit 1 janë Institucionet e Organizmave të Artit, Shkencës, Arsimit, Bibliotekave, Sallave të Leximit dhe Institucioneve Kërkimore Publike, të financuara plotësisht ose në pjesën më të madhe të tyre, nga mjetet e buxhetit.

Neni 7

Republika e Shqipërisë merr përsipër të sigurojë, brenda sovranitetit të saj territorial, që ndihmat austriake për institucionet arsimore dhe kërkimore të çlirohen nga tatimet dhe taksat e importit, si dhe nga taksa ose tatime të tjera. Këto mallra të importuara sipas kësaj marrëveshjeje, pa taksa ose tatim, mund të përdoren vetëm sipas qëllimit të përcaktuar, nuk ndërrojnë pronarin ose t'i lihen personave të tjerë për përdorim.

Neni 8

(1) Palët kontraktuese përpiqen të përmirësojnë njohjen reciproke të Kulturës së vendeve të tyre, të zhvillojnë më tej bashkëpunimin kulturor në të gjitha fushat e nivelet, duke kontribuar nëpërmjet saj për Identitetin Kulturor Evropian.

(2) Në këtë kuptim, ato do të bashkëpunojnë brenda mundësive të tyre, veçanërisht në fushat e:

- a) Letërsisë dhe Botimeve
- b) Teatrit, Muzikës, Vallëzimit, Arteve figurative,
- c) Arkitekturës, Dizenjove, Filmit, Fotografisë, Mediave të reja,
- d) Bibliotekave, Muzeumeve, Arkivave,
- e) Mbrojtjes së Monumenteve, Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore,
- f) Kulturës Popullore, dhe
- g) në kuadrin e Projekteve, Programeve dhe Institucioneve Evropiane.

(3) Palët kontraktuese mbështesin brenda mundësive të tyre vizitat afatshkurtra të artistëve/artisteve dhe ekspertëve/eksperteve për zhvillimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojës.

Neni 9

Palët kontraktuese mbështesin, në kuadrin e mundësive të tyre, bashkëpunimin në fushat e Sportit dhe Rinisë së të dy vendeve.

Neni 10

(1) Hyrjet e personave në Territorin e Palës tjetër kontraktuese dhe qëndrimi i tyre në këtë Territor, në kuadër të aktiviteteve, të cilat do vendosen në bazë të kësaj marrëveshjeje ose të një prej Programeve të vendosura nga Komisioni i Përbashkët, i nënshtrohen dispozitave në fuqi, përkatësisht të vendit tjetër, për udhëtimet, qëndrimin

dhe punësimin. Gjatë lëshimit të vizave, këta persona janë të përjashtuar nga pagimi i taksave dhe i shpenzimeve për formularët.

(2) Personat e dërguar për një periudhë afatgjatë mbi bazën e kësaj marrëveshjeje, në kontekstin e veprimtarisë së tyre, nuk i nënshtrohen kufizimeve të dispozitave ligjore të brendshme për punësimin në shtetin pritës. Ata janë të çliruar edhe nga kufizimet e dispozitave ligjore të vendit pritës për qëndrim, sepse nuk i nënshtrohen kufizimit për hyrje rishtas dhe nuk duhet të paraqesin një vërtetim të personit ku do të strehohen ose vërtetim mjekësor, si kusht për lëshimin e lejes së qëndrimit. Gjatë lëshimit të lejeve të qëndrimit, ata janë të çliruar nga pagesa e taksave dhe e shpenzimeve të formularëve.

Neni 11

(1) Palët kontraktuese, në kuadër të dispozitave të tyre ligjore, në bazë të reciprocitetit, do të krijojnë kushte të favorshme për veprimtarinë e specialistëve të dërguar për realizimin e kësaj marrëveshjeje, veçanërisht nëpërmjet asistencës për:

a) vendosjen e kontakteve me institucione, organizma dhe persona privatë të shtetit pritës në lidhje me çështje të bashkëpunimit kulturor;

b) sigurimin e vizave për specialistë dhe, nëse është e nevojshme, edhe për pjesëtarët e familjeve të tyre në linjë direkte, ku për qëndrime më të gjata se një muaj, do të pajisen me viza hyrje-dalje për shumë kalime, pa paguar tarifën përkatëse; kjo dispozitë vlen edhe për të afërmit që udhëtojnë me ta ose u vijnë për vizitë, si dhe për bashkëshortet e personave të cilët punojnë në vendin tjetër prej më shumë se 6 muajsh;

c) miratimin e hyrjeve dhe daljeve të sendeve personale, duke i çliruar nga tatimet e eksport-importit, duke përfshirë këtu një automjet dhe pajisjet për përdorim gjatë shërbimit.

d) regjistrimin e automjeteve, të cilët janë importuar nga specialistët për kohën e qëndrimit të tyre në vendin pritës;

e) evitimin e tatimit të dyfishtë mbi të ardhurat;

(2) personat të cilët, në bazë të kësaj marrëveshjeje ose të ndonjë programi pune në lidhje me këtë marrëveshje, punojnë në vendin tjetër, nuk i nënshtrohen kufizimeve për udhëtimet.

Neni 12

(1) Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje të krijohet një Komision i Përbashkët, i cili përbëhet nga përfaqësues të Palëve Kontraktuese. Ai mund të thirret nga secila Palë Kontraktuese. Komisioni i Përbashkët, në parim, takohet, alternativisht, në Republikën e Austrisë dhe në Republikën e Shqipërisë. Komisionin e kryeson gjithmonë shefi i delegacionit të përfaqësuesve të Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës zhvillohet takimi.

(2) Komisioni i Përbashkët harton dhe vendos programet për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, që përcaktojnë kushtet e organizimit dhe ato financiare, për realizimin e tyre, si dhe çështjet për përkujdesjen mjekësore të personave që do marrin pjesë në këtë shkëmbim.

(3) Ai bën bilancin për bashkëpunimin në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje dhe harton rekomandime për prioritetet e bashkëpunimit të mëtejshëm kulturor.

(4) Secila Palë Kontraktuese njofton në rrugë diplomatike përbërjen e delegacionit të përfaqësuesve të saj në Komisionin e Përbashkët dhe ndryshimet e mëvonshme.

(5) Komisioni i Përbashkët vendos me mirëkuptimin e të dy delegacioneve.

Neni 13


(1) Kjo marrëveshje kërkon miratimin sipas legjislacioneve në fuqi të dy Palëve Kontraktuese dhe hyn në fuqi ditën e parë të muajit të tretë, që pason muajin, kur Palët Kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim në rrugë diplomatike, se nëpërmjet dispozitave të tyre të brendshme, kanë plotësuar kushtet përkatëse për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

(2) Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë pesëvjeçare dhe vlefshmëria e saj zgjatet përkatësisht edhe me 5 vite të tjera. Marrëveshja mund të denoncohet me shkrim nga secila Palë Kontraktuese, të paktën gjashtë muaj para përfundimit të vitit kalenderik përkatës. Në rastin e denoncimit të kësaj marrëveshjeje, të gjitha programet dhe projektet në vazhdim, do të vijojnë më tej deri në përfundimin e tyre mbi bazën e marrëveshjes.

Bërë në Tiranë më 31 tetor 2005 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën gjermane dhe shqipe, ku të dy tekstet kanë vlerë të barabartë.



Për Qeverinë e Republikës së Austrisë



Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë